

# **VËNIA NË PROVË FUNKSIONON**

**Tiranë, 2016**



---

# VËNIA NË PROVË FUNKSIONON

---

**Për versionin origjinal :**

Bordi editorial përbërë nga Dr. René Butter nga Universiteti HU i Shkencave të Aplikuara të Utrehtit, Prof. Dr. Fergus McNeill nga Universiteti i Glasgout dhe Dr. Ioan Durnescu nga Universiteti i Bukureshtit.

**Botimi në gjuhën shqipe u mundësua nga:**



Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

# Hyrje

## **Vënia në provë: Çfarë dihet realisht mbi praktikat efikase të vënies në provë**

Disa fusha studimesh, politikash dhe praktikash janë vetiu pashmangshmërisht të diskutueshme dhe objekt kundërshtish. Por ndonëse njohja e këtyre fushave vazhdimisht rritet dhe përmirësohet, edhe në to mund të ketë disa çështje për të cilat mund të gjendet një konsensus i gjerë mes studiuesve, politikëbërësve dhe profesionistëve.

Zakonisht publiku i gjerë nuk ka mundësi të marrë informacione të tilla. Zbulimet e reja dhe të pazakonta tërheqin vëmendje të madhe. E megjithatë, në fushën e rehabilitimit, ri-integrimit dhe vënies në provë, është e rëndësishme që këto informacione të mund të merren nga publiku i gjerë, politikanët, politikëbërësit dhe punonjësit në terren; janë pikërisht këta punonjës që janë shpesh ekspertët e praktikave vendore, por që mund të mos kenë gjithmonë akses në informacione dhe studime të mëtejshme të fushës. Diskutimet publike, vendimmarrja, si dhe zhvillimi profesional dhe risitë duhet që të gjitha të marrin gjithmonë parasysh si njohuritë akademike, ashtu edhe ato profesionale.

Për Konfederatën Evropiane të Shërbimit të Provës, paraqitja e këtyre fakteve duket edhe më e rëndësishme në një fushë ku debati publik duket sikur dominohet nga emocionet, intuïta dhe 'logjika e thjeshtë'. Prandaj, Konfederata vendosi të kontraktojë një grup pune studiuesish për të punuar me disa klientë të autorizuar të Universitetit *Hogeschool* të Utrehtit (HU) për Shkenca të Aplikuara, për mbledhjen dhe organizimin e informacioneve shkencore të fjalës së fundit të teknologjisë në lidhje me rehabilitimin e të dënuarve të cilat mund të jenë me rëndësi për publikun e gjerë, për politikanët, politikëbërësit dhe për profesionistët e shërbimit të provës.

Ky informacion paraqitet në vijim në formën e disa pyetje-përgjigjeve. Njohuritë akademike kombinohen me njohuri shkencore të aplikuara nga bota e sanksioneve në komunitet. Në të kanë kontribuar disa nga ekspertët më të mirë të fushave të ndryshme.

Bordi editorial përbëhej nga Dr. René Butter nga Universiteti HU i Shkencave të Aplikuara të Utrehtit, Prof. Dr. Fergus McNeill nga Universiteti i Glasgout dhe Dr. Ioan Durnescu nga Universiteti i Bukureshtit.

Ky projekt është bërë i mundur me mbështetjen financiare të organizatës bamirëse holandeze *Nationale Reclasseringssactie*.

**Pyetjet** (klikoni në link për përgjigjen)

1. [Pse kryejnë njerëzit vepra penale?](#)
2. [Si ndalojnë njerëzit së kryeri vepra penale dhe pse?](#)
3. [Çfarë ndikimi kanë punonjësit e shërbimit të provës të vendimi i gjykatës dhe të promovimi i sanksioneve dhe masave në komunitet?](#)
4. [Si ndikon vënia në provë në uljen e përsëritjes së veprave penale dhe në heqjen dorë nga krimi?](#)
5. [Si ndikon vepra penale të përmbushja e dëshirës së publikut për drejtësi dhe ndëshkim?](#)
6. [Si ndikon vënia në provë të integrimi social i të dënuarit \(risistemimi\)?](#)
7. [Si ndikon vënia në provë në vendosjen e së drejtës së personave të dëmtuar dhe komuniteteve?](#)
8. [Si e përjetojnë të dënuarit mbikëqyrjen?](#)
9. [Si ndikon shërbimi në komunitet?](#)
10. [Cilat janë kostot dhe përfitimet e vënies në provë?](#)

## Pyetja 1

### Pse kryejnë njerëzit vepra penale?

*nga Rob Canton*

Universiteti *De Montfort*, Leicester (Mbretëria e Bashkuar)

Përgjigjet që mund t'i jepeshin pyetjes se pse njerëzit kryejnë vepra penale mund të mbushnin një bibliotekë të tërë. Në fakt, shumë specialistë të kriminalistikës tashmë kanë edhe dyshime nëse ka vend për një pyetje të tillë. Çdo përkufizim (i diskutueshëm) i krimit përfshin një gamë kaq të gjerë sjelljesh, saqë nuk ka asnjë shpjegim që të mund të ishte i plotë. Ndonjëherë, studiuesit e kanë trajtuar këtë pyetje, duke parë fillimisht se ku ndryshojnë autorët e veprave penale nga njëri-tjetri dhe janë përpjekur që të gjejnë mes tyre dallime biologjike (shpesh gjenetike), psikologjike (ndoshta të lidhura me përvojat në fëmijëri) ose sociologjike (duke marrë parasysh edhe ndikimet e shoqërisë, kulturës dhe sistemit socio-ekonomik). Shumë prej këtyre studimeve gjejnë vend për secilin faktor. Megjithatë, kriminologjia ka qenë përzgjedhëse këtu, duke u thelluar shpesh në disa lloje krimesh e duke lënë pas dore krime të tjera. (Kush studion gjenet për të shpjeguar grykësinë e kriminelëve me kostum e kollare? Apo krimet e dhunshme të krerëve të shteteve?) Ka disa gjëra që merren si të vërteta në këto hetime, por që mund të jenë të diskutueshme – kështu për shembull, merret si i vërtetë fakti që shumica e njerëzve nuk bëjnë krime (në fakt, ka mjaft arsye për të menduar se shumica prej nesh kryejnë një apo më shumë krime gjatë jetës) dhe se mes atyre që bëjnë krime dhe të tjerëve duhet të ketë patjetër dallime. E megjithatë, autorët e krimeve më të mëdha sillen pothuajse gjatë gjithë kohës si gjithë të tjerët.

Sa i përket punës së shërbimit të provës, një gjetje me shumë influencë ka qenë fakti që shumë autorë krimesh kanë aftësi të kufizuara të menduari ose mungesa kogjitive. Këtu bëhet fjalë për njerëz me kapacitet të kufizuar të cilë nuk mund t'i mendojnë mirë pasojat e veprimeve të tyre, por kjo mund të lidhet edhe me një sërë kufizimesh të tjera të aftësive të të menduarit dhe aftësive sociale, si dhe me një empati të kufizuar ndaj viktimave dhe ndaj të tjerëve. Duke qenë se mes vendimeve, sjelljeve dhe ndjenjave të njerëzve ekziston një lidhje e afërt dhe reciproke, këto studime janë përdorur për të krijuar disa programe për sjelljet kriminale mes psikologjisë së sjelljes kogjitive (Duke qenë se këto programe dhe sjellje e venë theksin tek të menduarit, rëndësia e ndjenjave shpesh neglizhohet – të paktën relativisht, e herë të tjera harrohet plotësisht).

Megjithatë, punonjësit e shërbimit të provës i dinë disavantazhet e mëdha sociale të shumë prej klientëve të tyre. Dhe ndonëse nuk është e vërtetë se sjellja konjitive e mohon rëndësinë e faktorëve socialë, ekziston rreziku që duke u fokusuar tek mendimet, sjelljet dhe ndjenjat e individit, të lihen mënjanë mënyrat e tjera të të kuptuarit të krimit – sidomos lidhjet mes kryerjes së krimeve dhe disavantazheve sociale dhe padrejtësisë. Kritikat bëhen edhe më të mprehta kur marrim parasysh pozitën e grupeve të caktuara, ndoshta veçanërisht pozitën e grave dhe të të dënuarve që u përkasin pakicave etnike, sjellja kriminale e të cilëve dhe përvoja që ata kanë me drejtësinë penale mund të kuptohet plotësisht vetëm në një kontekst më të gjerë social-politik. Studimet për heqjen dorë nga krimi dhe 'Modeli i Jetës së Mirë'

(për rehabilitimin e të dënuarve) kanë filluar ta korrigojnë këtë duke i kushtuar vëmendje përfshirjes sociale dhe duke këmbëngulur që heqja dorë nga krimi dhe rehabilitimi kërkojnë jo vetëm ndryshim të qëndrimeve dhe sjelljes së individit, por edhe krijimin e mundësive të drejta sociale për t'u dhënë një jetë në të cilën të mos ketë vend për krime. Prandaj, shërbimi i provës duhet ta inkurajojë shoqërinë që ajo ta mbështesë përfshirjen sociale dhe t'u japë klientëve të tij akses në shërbimet dhe mundësitë që u nevojiten – jo vetëm të adresojnë ndikimet individuale tek sjellja kriminale.



## Pyetja 2

### Si ndalojnë njerëzit së kryeri vepra penale dhe pse?

nga Lila Kazemian

Universiteti City i Nju Jorkut (USA)

Vlera dhe rëndësia e studimit të heqjes dorë nga krimi, sidomos në funksion të përpjekjeve për ndërhyrje pas ndodhjes së krimit theksohen mjaft në literaturë. Faktorët që ndikojnë në heqjen dorë nga krimi mund të klasifikohen sipas katër këndvështrimeve kryesore: biologjike, sociologjike, konjitive dhe psikologjike.

#### Faktorët biologjikë që ndikojnë në heqjen dorë nga krimi

Përveç pasojave të drejtpërdrejta që ka moshja tek heqja dorë nga krimi dhe ndryshimeve biologjike që çojnë në ulje të numrit të veprave penale që kryen njeriu me kalimin e moshës, studimet e fundit kanë shqyrtuar rolin që luajnë faktorët gjenetikë në procesin e heqjes dorë nga krimi. Kërkimet tregojnë se gjenetika ka një ndikim të rëndësishëm si tek martesja, ashtu edhe tek heqja dorë nga krimi. Rezultatet e tyre tregojnë se martesja mbetet një faktor i rëndësishëm për heqjen dorë nga krimi edhe pas kontrollit për ndikime gjenetike, por efektet e saj zbehen shumë.

#### Faktorët socialë që ndikojnë në heqjen dorë nga krimi

Një pjesë e madhe e studimeve për heqjen dorë nga krimi e kanë tërhequr vëmendjen tek rëndësia e lidhjeve sociale në procesin e heqjes dorë nga krimi, sidomos te martesja dhe punësimi. Heqja dorë nga krimi thuhet se është një proces gradual që rrjedh nga akumulimi i lidhjeve sociale. Për shembull, stabiliteti në martesë dhe në punë thuhet se ndikojnë rrënjësisht tek heqja dorë nga krimi, nëse ato ndodhin në të njëjtën kohë. Përveç efekteve të drejtpërdrejta që ka tek njeriu kontrolli më i madh social, martesja dhe punësimi e nxisin heqjen dorë nga krimi edhe duke ia ndryshuar individit aktivitetet rutinë dhe duke ia kufizuar mundësitë për të kryer krime. Po kështu, disa autorë janë të mendimit se martesja dhe punësimi e nxisin heqjen dorë nga krimi përmes ndërveprimeve më të mëdha mes bashkëshortëve dhe/ose kolegëve pro-socialë, duke u lënë më pak kohë me miq që mund të jenë 'devijantë'.

Analiza e famshme e autorëve të mitur të veprave penale në vitet 1950 (i njohur si studimi *Glueck*) tregoi se ushtria përbënte një kthesë të rëndësishme në procesin e heqjes dorë nga krimi, por analizat me kampionë më përfaqësues dolën me rezultate të ndryshme. Nevojiten më shumë studime me kampionë bashkëkohorë që përfaqësojnë persona që e kanë kryer shërbimin ushtarak.

Duke pasur parasysh kufizimet e ndryshme që u vë ligji personave që janë dënuar më parë për kryerje veprash penale, edhe politikat sociale (ashtu si dhe reagimet informale brenda familjes apo komunitetit) që nxisin etiketimin dhe stigmatizimin paraqesin pengesa të konsiderueshme për personat që dëshirojnë të heqin dorë nga krimi.

### **Faktorët konjitivë që ndikojnë te heqja dorë nga krimi**

Në literaturë është bërë një diskutim i gjerë rreth faktorëve konjitivë që ndikojnë në procesin e heqjes dorë nga krimi sipas teorisë së transformimit konjitiv, i cili përkufizohet si një lloj zhvendosjeje konjitive që nxit procesin e heqjes dorë nga krimi. Përshkruhen katër procese të transformimit konjitiv. Prosesi i parë i transformimit është kur personi që ka kryer një vepër penale është i hapur ndaj ndryshimit. I dyti është kur personi, përmes një procesi vetëpërzgjedhës, ekspozohet ndaj përvojave pro-sociale (p.sh. punësimit, etj.) që mund t'ia forcojnë më tej dëshirën për të hequr dorë nga krimi. Prosesi i tretë është ai kur personi duhet t'i përmbahet një identiteti të ri pro-social dhe jokriminal. Në fund, ndodh një ndryshim në mënyrën se si personi e percepton stilin kriminal të jetesës, d.m.th. qartësohet për pasojat negative të kryerjes së një krimi.

Autorë të ndryshëm kanë theksuar rëndësinë e transformimit të identitetit në procesin e heqjes dorë nga krimi, duke argumentuar se për të hequr dorë nga krimi, ish të dënuar duhet të zhvillojnë një identitet të fortë, të besueshëm dhe pozitiv për vete dhe për të ndarë në njëfarë mënyre veten e vet të së kaluarës nga ajo e së tashmes.

Të tjerë faktorë konjitivë që identifikohen në literaturën mbi heqjen dorë nga krimi përfshijnë teknikat e neutralizimit dhe atribuimit të fajit, optimizmin rreth mundësisë reale të heqjes dorë nga krimi, si dhe këmbënguljen dhe vendosmërinë. Ndonëse përdorimi i substancave të ndryshme është tregues sjelljeje, ai ushtron ndikim edhe në proceset konjitive dhe ka rezultuar si një pengesë e konsiderueshme për heqjen dorë me sukses nga krimi.

### **Faktorët psikologjikë që ndikojnë në heqjen dorë nga krimi**

Një nga dimensionet më interesante të procesit të heqjes dorë nga krimi ka të bëjë me mënyrën se si predispozitat individuale dhe ngjarjet e rëndësishme të jetës konvergojnë në nxitjen e këtij procesi. Shumë studiues bien dakord se njeriu mund të heqë dorë nga krimi si rrjedhojë e kombinimit të ndikimit të faktorëve socialë dhe konjitivë. Gjetje të tjera kanë treguar se gjendjet subjektive kanë pasoja të drejtpërdrejta dhe të tërthorta tek recidivizmi përmes ndikimit të tyre në rrethanat sociale. Personat me një mendësi pozitive dhe me rrethe sociale mbështetëse kanë më shumë mundësi t'i përballojnë problemet, t'u rezistojnë tundimeve dhe të shmangin kthimet prapa, me kusht që pengesat të mos jenë të ekzagjeruara. Kështu, heqja dorë nga krimi konsiderohet si e influencueshme nga sistemi i ndërveprimit mes faktorëve të ndryshëm të brendshëm dhe të jashtëm.

## Pyetja 3

### Çfarë ndikimi kanë punonjësit e shërbimit të provës te vendimi i gjykatës dhe te promovimi i sanksioneve dhe masave në komunitet?

nga George Mair  
Universiteti *Liverpool Hope* (Mbretëria e Bashkuar)

Vendimi për ndëshkimin e autorëve të veprave penale është një proces kompleks dhe me shumë nuanca. Vendimi se çfarë dënimi duhet marrë ndaj një autori të një veprë penale merret nga gjyqtarë që kanë relativisht jo shumë informacion të pavarur dhe të paanshëm për autorin e veprës penale dhe që nuk e njohin shumë atë, rrethin e tij apo kontekstin e gjerë në të cilin është kryer krimi. Veçanërisht në sistemet me palë kundërshtarë në gjyq, avokatët mbrojtës e përshkruajnë sa më pozitivisht që të jetë e mundur klientin e tyre për të përfutur një dënim sa më të lehtë, kurse prokuratorët, nga ana tjetër, tentojnë të synojnë një dënim sa më të rëndë dhe të pandehurin e përshkruajnë pikërisht në funksion të këtij synimi.

Në këtë fushë deklarimesh shumë të njëanshme dhe konfliktuale, punonjësit e shërbimit të provës mund të bëjnë një vlerësim më 'objektiv' të autorit të veprës penale dhe një përmbledhje të avantazheve dhe disavantazheve të dënimeve të mundshme. Edhe pse në disa juridiksione (për shembull, në Angli dhe në Uells janë rritur masivisht raportet verbale të përditshme gjatë dhjetëvjeçarit të fundit), është ngushtuar objekti i raporteve që paraqesin në gjykatë punonjësit e shërbimit të provës dhe është shkurtuar koha e përgatitjes së raportit në disa juridiksione punonjësit e shërbimit të provës mund të ofrojnë një opinion të pavarur në shkallë të arsyeshme mbi mënyrën se si mund të reagojë autori i veprës penale ndaj një dënimi të caktuar. Duke qenë se kur e dimë se një dënim i caktuar ka më shumë gjasa që të kryhet i plotë dhe se mundësitë për përsëritje të veprës penale përkatëse janë më të vogla nëse i dënuari reagon pozitivisht ndaj dënimit (nëse i dënuari e sheh dënimin si legjitim), atëherë mendimi i punonjësve të shërbimit të provës duket si një komponent i paçmueshëm i procesit të dënimit.

Shumë studime kanë treguar se shkalla e përputhjes së propozimeve të shërbimit të provës dhe vendimeve të gjykatës është e lartë dhe ndonëse mund të ketë edhe arsye të tjera për këtë (p.sh. punonjësit e shërbimit të provës mund ta marrin me mend se çfarë vendimi mund të marrë gjykatësi), kjo tregon se ndikimi i punonjësve të shërbimit të provës në ofrimin e informacioni dhe këshillimit për gjyqtarët për të ndihmuar në marrjen e vendimeve prej tyre është i konsiderueshëm.

Megjithatë, punonjësit e shërbimit të provës në të gjithë këtë proces nuk është se janë pjesëmarrës tërësisht të painteresuar. Ofrimi i këshillave gjyqtarëve luan një rol kyç në promovimin e sanksioneve në komunitet. Pikësisht, gama dhe kombinimi i këtyre masave mund të jenë të komplikuar dhe gjyqtarët duhet të kujtohen vazhdimisht për ekzistencën dhe potencialin e dënimeve në komunitet si masa efektive që mund të marrë gjykata.

Së dyti, duke promovuar sanksionet në komunitet, punonjësit e shërbimit të provës mund të dekurajojnë marrjen e dënimeve më ndëshkuese, duke iu shmangur marrjes së një vendimi me burg për autorin e veprës penale. Kjo do të çonte në uljen e popullimit të burgjeve dhe në përdorimin e dënimeve më njerëzore dhe më efikase, pasi ashtu si tregojnë edhe provat, dënimet në komunitet janë të paktën po aq të suksesshme sa burgimi sa i përket shkallës së përsëritjes së veprave penale dhe kanë kosto mjaft më të ulëta.

Së treti, nëse nuk do të ishin punonjësit e shërbimit të provës ata që do të promovonin në mënyrë aktive sanksionet në komunitet, kush do t'u kërkonte vazhdimisht gjyqtarëve që të kishin një qasje më pak ndëshkuese dhe më të kujdesshme. Kjo mund të luajë një rol të vogël, por të konsiderueshëm në ngadalësimin e rritjes së kulturës ndëshkuese – edhe pse do ishte e tepruar nëse do të shpresonim se kjo mund ta ndryshonte tërësisht këtë lloj kulture.

Punonjësit e shërbimit të provës nuk kanë ndonjë vitrinë ku të ekspozojnë atë çka ato ofrojnë; vetëm gjykata mund t'u ofrojë vendin e duhur për të reklamuar shërbimet e tyre para konsumatorëve më të rëndësishëm – gjyqtarëve. Ndonëse detyra kryesore e punonjësve të shërbimit të provës është që të mbikëqyrin të dënuarit në komunitet, roli i tyre më influencues mund të jetë ai i këshillimit në procesin e vendimmarrjes së gjykatës për dënimin e autorëve, duke promovuar kështu përdorimin e sanksioneve në komunitet.

## Pyetja 4

### Si ndikon vënia në provë në uljen e përsëritjes së veprave penale dhe në heqjen dorë nga krimi?

*nga Fergus McNeill*

*Universiteti i Glasgow (Mbretëria e Bashkuar)*

Në shumicën e juridiksioneve, ulja e përsëritjes së veprave penale ka qenë prej kohësh një nga qëllimet kryesore të vënies në provë. Megjithatë, vlerësimi i efikasitetit të këtij shërbimi në këtë aspekt nuk është aspak i thjeshtë.

Nga ana tjetër, edhe përsëritja e veprës penale nuk është aq e thjeshtë për t'u matur; treguesi me të cilin ajo matet zakonisht – ridënimi – është rrjedhojë e një sërë procesesh sociale (të cilat që të gjitha mund të mbartin një lloj njëanshmërie). Përveç kësaj, ridënimi përkufizohet dhe matet ndryshe në vende të ndryshme (me riarrestim, ridënim dhe riburgim) dhe u referohet periudhave të ndryshme kohore; kurse matja e ridënimit sipas kategorive përsëritës ose jo, nuk merr parasysh shkallën dhe shpeshtësinë e ridënimit.

Nga ana tjetër, vetë 'vënia në provë' nuk është një ndërhyrje e vetme dhe uniforme e përkufizuar thjesht; sanksionet në komunitet mund të marrin forma nga më të ndryshme në kushte ligjore, procese ndërpersonale dhe qasje të ndryshme ndërhyrjesh në punë. Edhe kur urdhrat e vënies në provë mund të duken njëlloj nga ana formale, natyra e mbikëqyrjes (dhe ndikimi i saj) varen shumë nga marrëdhënia mes mbikqyrësit dhe të mbikqyrurit.

Dhe nëse rezultatet janë të vështira për t'u matur dhe proceset të vështira për t'u përkufizuar dhe për t'u përshkruar, edhe kontekstet ku realizohet vënia në provë janë nga më të ndryshmet e këto ndryshime mund të jenë të rëndësishme. Një aspekt i kontekstit mund të jetë profili i klientelës. Edhe pse vënia në provë duket se funksionon më mirë sesa burgimi sa i përket ridënimit në shumë vende, pjesa më e madhe e ndryshimeve në shkallën e ridënimit lidhet me ndryshimet në numrin e të dënuarve që vihen në provë dhe në popullimin e burgjeve; grupi i fundit ka më shumë gjasa të jetë objekt dënimesh të tjera për kryerje veprash penale. Kur këto ndryshime mbahen nën kontroll, vënia në provë prapëseprapë funksionon më mirë sesa burgimi, por ndryshimet janë shumë më të vogla sesa mund të dëshirojmë – dhe nuk e dimë nëse ato vijnë nga efektet pozitive të vënies në provë apo nga efektet negative të dënimit me burgim.

Një faktor dytësor kontekstual është konteksti më i gjerë social. Duket sikur është e qartë se një urdhër për vënie në provë ka më shumë gjasa të 'funksionojë' nëse personi që vendoset në provë është i motivuar, nëse ka një familje që e mbështet dhe nëse ka mundësi të bollshme punësimi në një treg të pasur pune, nëse ka akses në shërbime shumë të mira për kujdes shëndetësor dhe mirëqenie, nëse gëzon strehim të sigurt dhe të denjë dhe nëse publiku është përgjithësisht më pak ndëshkues dhe përjashtues, etj. Në rrethana të tilla, ajo çka mund të duket si arritje e shërbimeve të provës mund të jetë në të vërtetë rrjedhojë e konteksteve sociale dhe strukturore.

Në fakt, në një prej studimeve të pakta që janë bërë për shqyrtimin në mënyrë sistematike të marrëdhënieve midis vënies në provë dhe heqjes dorë nga krimi, u konstatua fillimisht se motivimi i vënies në provë dhe konteksti social ishin shumë më të rëndësishme për të shpjeguar heqjen dorë nga krimi sesa përmbajtja apo cilësia e mbikëqyrjes. Megjithatë, interesante ishte që u ndoq ecuria e një grupi personash që kishin qenë vënë më parë në provë përgjatë 10 vjetëve pas shërbimit të provës dhe u pa se vënia në provë mundet ndonjëherë të ushtrojë dhe ushtron në të vërtetë një efekt pozitiv, por jo gjithmonë aq shpejt sa do të kishim dashur.

Aty ku punonjësit e shërbimit të provës krijojnë marrëdhënie të mira me personat e vënë në provë dhe ku bëjnë një punë të dobishme dhe konstruktive, ata janë në gjendje të 'mbjellin farën' e ndryshimit, por jo domosdoshmërisht ta 'prodhojnë' ndryshimin. Kjo mënyrë të menduari rreth efekteve të vënies në provë – në thelb si një influencë graduale e ndërtuar në bazë marrëdhëniesh – është më konsistente sa i përket teorisë dhe studimeve mbi heqjen dorë nga krimi në përgjithësi, si dhe me disa aspekte të literaturës së re që mundohet të përcaktojë 'Çfarë funksionon më mirë?'.

Kështu, ndoshta paraprakisht duhet të dalim në përfundimin se disa forma dhe përvoja të mbikëqyrjes së të dënuarve në provë, realizuar në mënyra të caktuara nga mbikëqyrës të caktuar, janë në gjendje të mbështesin dhe realisht e mbështesin heqjen dorë nga krimi dhe uljen e ridënimit, por që ky 'efekt' mund të ndryshojë jo thjesht për shkak të mënyrës se si e masim ndryshimin, por edhe nga konteksti social dhe marrëdhëniet në të cilat ky ndryshim mbështetet ose vështirësohet.

## Pyetja 5

### Si ndikon vepra penale te përmbushja e dëshirës së publikut për drejtësi dhe ndëshkim?

*nga Rob Allen*

*Bashkëdrejtor për Drejtësinë dhe Burgjet (Mbretëria e Bashkuar)*

Studimet mbi qëndrimet e publikut ndaj drejtësisë janë të vështira për t'u interpretuar për shkak se rezultatet e sondazheve varen shumë nga formulimi specifik i pyetjeve që bëhen në to. Një sondazh i kohëve të fundit në Mbretërinë e Bashkuar konstatoi se katër të pestat e publikut i konsideronin dënimet në komunitet si ndëshkime të buta. Por shumica e njerëzve nuk kanë dijeni mbi dënimet alternative që mund të japin gjyqtarët në juridiksionet e tyre. Edhe vënia në provë, dënimi në komunitet që përdoret më gjerësisht dhe më i vjetri nga të gjithë në shumicën e vendeve nuk njihet mirë nga shumë njerëz. Pa ndonjë shpjegim mbi atë çka përbëjnë në të vërtetë dënimet në komunitet, është vështirë të thuhet se ku e bazon publiku mendimin e tij mbi kontributin që jep vënia në provë në drejtësi apo në dënim. Shumë pak njerëz e përmendin spontanisht vënien në provë si një mënyrë të reduktimit të krimit krahasuar me policinë e madje edhe me shkollat.

Nga ana tjetër, mbledhja e mendimeve të informuara rreth vënies në provë është e rëndësishme në këtë epokë të 'populizmit penal'. Për këtë arsye, në një studim të kohëve të fundit, para se të intervistuarve t'u kërkohej mendimi në lidhje me aktivitetet e ndryshme të vënies në provë u shpjegua fillimisht kuptimi i tyre. Pavarësisht problemeve metodologjike, dalin një sërë konstatimesh konsistente. Së pari, studimet krahasuese tregojnë se qëndrimet ndaj ndëshkimit ndryshojnë shumë nga një vend në tjetrin. Në një studim të vitit 2000, kur njerëzit u pyetën se çfarë dënimi duhej dhënë në rastin e një vjedhjeje, shumica në Britani dhe në Holandë zgjodhën dënimin me burg, kurse në shumë vende të Evropës dhe në Skandinavi opioni më popullor ishte shërbimi në komunitet.

Së dyti, sa herë që ngrihen shqetësime rreth vënies në provë dhe dënimeve në komunitet, ato kanë të bëjnë jo vetëm me mjaftueshmërinë e dënimit, por edhe me cilësinë e zbatimit të tij. Punonjësit e shërbimeve të provës nuk perceptohen sikur bëjnë një punë të mirë krahasuar me policinë dhe të dënuarit shihen ndonjëherë sikur ia hedhin me një mbikëqyrje të dobët.

Së treti, këto qëndrime janë formuar më shumë përmes medias sesa përmes përjetimeve personale. Qëndrimet negative ndaj dënimeve në komunitet kanë qenë më shumë sesa dy herë më dominuese krahasuar me ato pozitive në një studim të fundit të gazetave angleze, gjë që tregonte një armiçësi të rrënjosur ndaj tyre. Një studim në Irlandë konstatoi se shumica e mbulimit të vënies në provë nga media ishte ose pozitiv ose neutral, por vuri re se kishte një tendencë drejt një mbulimi me tone më negative.

Ka një sërë treguesish për mënyrën se si mund të rritet mbështetja e publikut. Atu ku shërbimi në komunitet i sjell përfitime të prekshme lagjjes përkatëse, ai mund të prodhojë një reagim

pozitiv nga banorët. Edhe kufizimi i lirisë dhe mbikëqyrja elektronike mund të fitojnë mbështetje nëse shpjegohen. Njerëzit gjithashtu pranojnë se disa lloje autorësh veprash penale kërkojnë një tjetër trajtim, sidomos ata që vuajnë nga sëmundjet mendore, varësia nga droga dhe gratë me fëmijë të vegjël.

Ajo çka është më e rëndësishme është se argumentet statistikore rreth efikasitetit të dënimeve alternative janë të prirura të kenë më pak ndikim sesa argumentet rreth vlerave dhe parimeve që qëndrojnë në thelb të tyre: zhdëmtimi, të bërit njerëz të mirë dhe të mësuarit se “si jetojnë njerëzit e mirë” dalin shpesh në një studim të kohëve të fundit. Kështu që përveçse informim më i mirë duket se nevojitet edhe një apel drejtuar anës emocionale të njerëzve.

Por mëshimi tek aspektet ndëshkuese të vënies në provë – për shembull detyrimi i të dënuarve në shërbimin e provës që të vishen me uniforma në ngjyrë të fortë portokalli – mund të kërcënonte vlerat themelore të vënies në provë. Me të drejtë, vënia në provë nuk mund ta kufizojë kurrë lirinë apo t’i ndëshkojë të dënuarit aq sa burgimi. Prandaj, përpjekjet për të përmbushur dëshirën e publikut për drejtësi duhet të përfshijnë edhe përpjekjet për të ndikuar te konceptimi i drejtësisë dhe te zhvillimi i një shpjegimi të mirë dhe të qartë të rolit që luan vënia në provë.



## Pyetja 6

### Si ndikon vënia në provë te integrimi social i të dënuarit (risistemimi)?

*nga Maurice Vanstone (Profesor Emeritus)  
Universiteti Swansea (Mbretëria e Bashkuar)*

Burgimi mund të mos jetë ideuar për të shkaktuar dëme të përhershme, por ajo prapëseprapë shkakton me qëllim një lloj dhimbjeje dhe pikërisht nga ky paradoks rrjedhin problemet kryesore të risistemimit të të burgosurve (apo rikthimit në jetën e zakonshme, siç e quajmë disa).

Në fakt, burgimi mund të sjellë pasoja të paqëllimshme dhe, si rezultat i mjedisit shoqëruar fuqimisht ndikues, mund të minojë mundësitë për risistemim të suksesshëm. Prandaj, është thelbësore që të zbutet si dëmi i shkaktuar nga burgimi, ashtu edhe problemet që sjellin të burgosurit në burg, me qëllim që ata të jenë në gjendje të bëjnë një jetë konstruktive larg krimit dhe shoqërisë t'i garantohet mbrojtje.

Për një periudhë prej 50 a më shumë vjetësh, qoftë në Skandinavi, Rumani, Angli apo Amerikë, kërkimet kanë evidentuar se shumica e problemeve me të cilat përballen të burgosurit lidhen me strehimin, punësimin, arsimimin, jetën familjare, varësinë, shëndetin mendor, menaxhimin e zemërimit, aftësitë për zgjidhjen e problemeve dhe me mungesat në aftësitë e të menduarit. Gjithashtu, kërkimet tregojnë se të burgosurit që iu përkasin pakicave etnike vuajnë edhe nga problemet e viktimizimit, kurse grave iu duhet të përballen me probleme të dhunës nga partnerët, abuzimin seksual, izolimin social dhe vetëdëmtimin.

Siç tregon edhe ndryshimi i politikave në fund të shekullit XX (më së fundmi në Rumani), heqja e këtyre pengesave për risistemim të suksesshëm varet, ndër të tjera, nga forcimi i lidhjeve midis të burgosurit, familjes dhe komunitetit. Edhe pse ka shumë modele nëpër botë, shërbimi i provës perceptohet gjithmonë si i përfshirë në këtë proces.

Po cili është ndikimi pozitiv i shërbimit të provës tek risistemimi i të dënuarve? Përgjigjja e drejtpërdrejtë është se kërkimet kumulative e lënë të paqartë: siç nënvizon Joan Petersilia, siguria mungon, sepse ekzistojnë shumë pak studime solide nga ana metodologjike.

Sidoqoftë, risistemimi i suksesshëm kërkon pashmangshmërisht bashkëpunim ndër-institucional, për shkak se janë në lojë një sërë problemesh dhe shumë faktorë shoqërorë, politikë dhe organizativë. Pikërisht për këtë arsye, edhe pyetja që bëhet për sistemin e provës i mëshon më shumë kontributit që jep ky shërbim në procesin e ri-integrimit shoqëror. Pavarësisht kësaj pasigurie, studimet hedhin dritë mbi disa komponentë të kontributit të shërbimit të provës që përbëjnë premisa për sukses.

Kërkimet tregojnë se ky kontribut duhet të jepet duke marrë më shumë informacion nga kërkime më të përgjithshme sesa ato që tani quhen studime mbi heqjen dorë nga krimi. Gjithashtu, në bashkëpunim me të gjitha palët, shërbimi i provës duhet të fokusohet te problemet që lidhen

me sjelljen dhe qëndrimin që i ka çuar autorët e veprave penale në burg dhe të nxisë një proces ndryshimi të drejtuar nga vetë i burgosuri, proces ky që njeh dhe vlerëson rëndësinë e:

- aftësisë së individit për t'u përballur me problemet personale dhe praktike që mund t'i dalin (studimet tregojnë se reagimet negative ndaj problemeve të përditshme çojnë në përsëritje të veprës penale);
- nevojave specifike të individit (dhe jo të mendohet se të gjithë autorët e veprave penale kanë nevoja të ngjashme);
- kontributit që mund të japin familjarët apo persona të tjerë të rëndësishëm në rrethin shoqëror të individit;
- strategjive që parandalojnë përsëritjen e veprave penale; dhe
- referimit të duhur te agjencitë/organet e tjera që mund të asistojnë në ri-integrimin shoqëror.

Për më tepër, potenciali për sukses i strategjisë së risistemimit rritet nëse personeli i shërbimit të provës krijon besim dhe respekt dhe:

- ofron vazhdimësi në marrëdhëniet e punës;
- fillon punën me individin që para lirimit (d.m.th. në burg);
- asiston individin në procesin e motivimit, duke përdorur një program konjitiv-motivues;
- ndihmon individin të përftojë aftësi për t'u përshtatur dhe më gjerë;
- inkurajon individin të pranohet nga komuniteti, duke marrë përgjegjësi për sjelljen dhe duke dhënë ndihmë të prekshme e praktike për pjesëtarët e komunitetit (me fjalë të tjera, bëhet pro-social).

Si përfundim, kërkimet tregojnë se kjo ndihmë rritet nga prania e një këshilluesi (mentori).

## Pyetja 7

### Si ndikon vënia në provë në vendosjen e së drejtës së personave të dëmtuar dhe komuniteteve?

nga Leo Van Garsse  
Universiteti i Gentit (BE)

Vendosja e të drejtës (reparacioni)

Përvoja ka treguar se të dëmtuarit shpesh i perceptojnë premiset e “vendosjes të së drejtës” si ofendim. Përballë këtij “qëllimi”, ato ndihen sikur përvoja e tyre nuk merret seriozisht. Kjo është ndoshta një nga arsytet pse të dëmtuarit e krimeve të rënda zgjedhin, të paktën në fillim, që të refuzojnë qasjet apo masat e vendosjes të së drejtës.

Mesa duket, këtë përvojë ka pasur parasysh Parlamenti Evropian në një direktivë për të drejtat e të dëmtuarve, ku thekson më shumë të drejtën e personit të dëmtuar për të refuzuar masat restauruese apo mbrojtjen ndaj rreziqeve të tyre, se sa të drejtën për të pasur akses në to. Megjithatë, ky qëndrim nuk merr parasysh se sa më i rëndë krimi, aq më shumë të dëmtuarit priren të tërhiqen nga ngjarja apo pasojat e saj. E rëndësishme është që personat e dëmtuar të mos jenë thjesht marrës pasiv të informacionit apo dëmshpërblimit, por të marrin vërtet një qëndrim që vlen për të dënuarit, sistemin e drejtësisë penale dhe shoqërinë.

Disa studiues (përfshirë edhe mua) janë pro ndryshimit të terminologjisë nga “vendosje e së drejtës / reparacion” dhe “restaurim” në “bashkëpërfshirje” në të bërit drejtësi. Këtu theksi zhvendoset nga një projektim autoritar i një rezultati të dëshiruar në një ftesë qytetare të hapur, bazuar në proces. Pyetja kyçe ka të bëjë me identitetin personal: kush isha unë në procesin e përballjes me këtë ngjarje? Ky arsyetim ka peshë institucionale dhe politike, sepse qytetari (qoftë i dëmtuari, i dënuari apo një qytetar i zakonshëm) duhet të jetë jo thjesht konsumues të drejtash, por një bashkëaktor në të kuptuarit të drejtësisë.

“I dëmtuari” dhe “Komuniteti”

Nocionet “i dëmtuar” dhe “komunitet” përdoren rëndom, por mbartin paqartësi. Koncepti i të dëmtuarit mund të përkufizohet gjerësisht si “çdo person/organizatë i prekur nga një ngjarje ekonomikisht, emocionalisht...”. Ky përkufizim i gjerë përfshin familjet e të dënuarve, fqinjëve, miqve, shkollën, etj. Nocioni i “të dëmtuarit” mund të kufizohet edhe vetëm për ata që autoritetet gjyqësore i njohin si palë formale në një çështje specifike.

Në këtë qasje të ngushtë, shumë shqetësime të qytetarëve shpërfillen ose cilësohen pa vend, duke e larguar procesin e “të bërit drejtësi” nga realitetet shoqërore. Ky proces mund të shkaktojë shumë viktimizim dytësor. Por, të dëmtuarit “zyrtarë” mund të ndiejnë detyrimin që të jenë “të dëmtuar të mirë” edhe të marrin rolin e pritshëm si jo vetëm të dëmtuar materialisht disi, por edhe si “të tronditur” moralisht. Luajtja e rolit të të dëmtuarit, sidomos në rastet e

krimeve të lehta, mund të perceptohet nga “të dëmtuarit” si barrë: një përgjegjësi edukative që “ia kanë borxh” disi të dënuarit (në moshë të re).

Nga ana tjetër, koncepti strikt anglosakson i “komunitetit” po bëhet gjithnjë e më i vagët në shumë shoqëri të urbanizuara, të burokratizuara dhe shumëkulturëshe. Kjo e bën disi artificiale idenë e “komunitetit të dëmtuar që ka nevojë për vendosje të së drejtës”, edhe shpesh perceptohet si justifikim i cekët për ndërhyrjen e publikut. Kjo bëhet e qartë kur analizojmë diskutimet se çfarë lloj aktiviteteve mund të konsiderohen “shërbime komunitare”; shumë shpesh, këto diskutime fokusohen thjesht te gjërat që u vijnë për shtat disa qytetarëve. Edhe për pastrimin e një lulishteje publike që aplikohet shpesh si shërbim në komunitet, mund të bëhen pafundësi supozimesh që rrallëherë janë studiuar duke i vënë përballë perceptimit të njerëzve për vlerën dhe kuptimin e kësaj pune në kontekstin e “shlyerjes”.

### Nocioni i “vënies në provë”

Për aq kohë sa vënia në provë aplikohet si një masë “e butë” për krime të lehta të kryera nga të rinj apo të dënuar për herë të parë, atëherë ajo shihet si favor, duke peshuar njësoj si perspektivën e viktimës, edhe përgjegjësinë publike të shkelësit.

Të detyrosh të dënuarin të dëmshpërblejë të dëmtuarin, të angazhohet në ndërmjetësim apo të bëjë “diçka për komunitetin” presupozon që i dëmtuari apo komuniteti janë mbartës të nevojave dhe pritshmërive konsistente me rolin e tyre në këtë qasje kontrolluese dhe disi edukative.

Me këtë linjë mendimi, përcaktimi i rasteve të pështatshme për të vënë në provë, nuk duhet të jetë çështje rregullimi ligjor apo përzgjedhjeje detyruese të bërë nga ekspertët; përkundrazi, duhet parë dhe mbështetur motivimi individual e social dhe kapacitetet qytetare të palëve të përfshira: të të dëmtuarve, dënuarve dhe komuniteteve përkatëse. Kjo logjikë duhet të përfshijë edhe çështjet më të rënda.

Nuk ka arsye, në mos ideologjike dhe antidemokratike, që të mos lejohen palët e përfshira për të kontribuar në vetë integrimin konstruktiv në “jetën reale”. Në këtë aspekt, vlera e vënies në provë qëndron jo te dhënia e zgjidhjeve “të lehta”, por duke përqsasur sfidat njerëzore dhe sociopolitike me një rezultat të pasigurt.

Një qasje e tillë e sheh shërbimin e provës jo si masë alternative ndaj dënimit “real”, por si një apel për pjesëmarrje qytetare, që respekton mbrojtjen ligjore dhe që është e hapur për përfshirjen dhe kontrollin e publikut me qëllim që të ndërtohet (dhe të rindërtohet vazhdimisht) në praktikë koncepti i “drejtësisë” në një shoqëri demokratike. Kjo lloj drejtësie lë hapësirë për restaurim, jo si mënyrë e lehtë për të siguruar vendosje të së drejtës apo dëmshpërblim, por si proces i ripozicionimit të njeriut në raport me ngjarjen kriminale dhe pasojat e saj, si edhe në raport me bashkëqytetarët tanë.

Kjo sfidë pedagogjike adreson jo vetëm të dënuarin dhe të dëmtuarin, por ka edhe një dimension sociopedagogjik; thirrje për mjediset shoqërore (përfshi të dëmtuarin dhe të dënuarin) që të shqyrtojnë me kujdes dhe gradualisht të zgjerojnë aftësitë e tyre në përgjigje të krimit, si edhe të kontribuojnë në mënyrë konstruktive në procesin e përcaktimit dhe ripërcaktimit të rendit shoqëror në një shtet ligjor demokratik.

## Pyetja 8

### Si e përjetojnë të dënuarit mbikëqyrjen?

*nga Ioan Durnescu*

*Universiteti i Bukureshtit (RU)*

Mbikëqyrja e të dënuarve ka një histori të gjatë, por studimet që analizojnë përjetimin subjektiv të subjekteve të kësaj mbikëqyrjeje janë të paktë në numër.

Përjetimi i mbikëqyrjes ndikohet nga disa faktorë, disa prej të cilëve lidhen me mënyrën si konceptohen dënimet. Në këtë aspekt, mbikëqyrja po sofistkohet vazhdimisht dhe po mbështetet në teknologji gjithnjë e më shumë. Shembull tipik është mbikëqyrja elektronike.

Disa vende ua kanë hequr të dënuarve të drejtën e dhënies së pëlqimit për disa forma të mbikëqyrjes (p.sh. Urdhri i Komunitetit në Angli dhe Uells). Në plot vende, numri i kushteve dhe detyrimeve që shoqërojnë mbikëqyrjen është rritur kaq shumë, sa që disa thonë se mbikëqyrja ka filluar të ngjajë si një «burg virtual».

Faktor tjetër që ndikon në përjetimin e mbikëqyrjes është edhe praktika e mbikëqyrjes. Nëse praktika perceptohet si legjitime dhe transparente, atëherë të dënuarit priren ta shohin mbikëqyrjen si një mundësi të mirë për të nisur një jetë të re dhe për të shmangur burgun. Gjithashtu, nëse mbikëqyrja përshkruhet si e fokusuar në zgjidhjen e problemit apo në nevojat e mirëqenies së të dënuarit, atëherë ajo perceptohet si e dobishme prej tyre. E njëjta gjë vlen edhe kur punonjësit e shërbimit të provës tregohen të arsyeshëm, të hapur, fleksibël dhe të besueshëm. Por vlen edhe e kundërta, nëse të dënuarit perceptojnë mbikëqyrjen si një proces me procedura jo shumë të drejta dhe që ndërhyjnë shumë në jetën e tyre, atëherë priren ta shohin me sy negativ.

Tension vërehet edhe në aplikimin e mbikëqyrjes elektronike. Ndonëse disa të dënuave u pëlqen kjo mundësi për të shmangur burgun dhe bëjnë një jetë “pothuaj normale,” por të tjerë thonë se mbikëqyrja elektronike i vë nën presion psikologjik dhe u shkakton stres, frikë dhe tundim.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për shërbimin në komunitet. Studimet konstatojnë se të dënuarit e konsiderojnë të dobishëm këtë dënim dhe e ndiejnë se përfitojnë diçka personalisht. Por, studimet tregojnë edhe se disa të dënuar e kanë shumë të vështirë të ruajnë këtë përkushtim afatgjatë edhe të pranojnë idenë për të punuar pa pagesë.

Shumica e studimeve ekzistuese mbi përjetimin e mbikëqyrjes bazohen në një numër të kufizuar subjektsh dhe në intervista të thelluara me shkelësit. Tashmë është e qartë se për të kuptuar të gjitha aspektet e plota të ndërveprimit mes të dënuarve dhe mbikëqyrësve, në të ardhmen duhet të hartohen metodologji etnografike të reja dhe më të shumta në numër.

Fatmirësisht, studiuesit po ngrihen në lartësinë e kësaj sfide. Në të ardhmen e afërt, do të dimë shumë më tepër se çfarë mendojnë dhe çfarë ndiejnë të mbikëqyrurit, si edhe çfarë ndikimi ka tek ata dhe personat që i rrethojnë.

## Pyetja 9

### Si ndikon shërbimi në komunitet?

*nga Gill McIvor*

*University of Stirling (Mbretëria e Bashkuar)*

Shërbimi në komunitet nënkupton që i dënuari duhet të kryejë një numër të caktuar orësh pune të papaguar në dobi të komunitetit. Ky dënim aplikohet gjerësisht në juridiksionet perëndimore, madje në faza të ndryshme të procesit penal. Në shumicën e juridiksioneve, kjo masë aplikohet si alternativë ndaj burgimit, ose si penaltet në komunitet *per se*; por, në disa juridiksione, i dënuari detyrohet të kryejë punë të papaguar si alternativë ndaj burgimit për mospagim gjobe, apo si alternativë ndaj procedimit penal. Përfitues të kësaj pune mund të jenë individë ose OJF. Puna mund të konsistojë në shërbime personale ose, siç ndodh rëndom, në detyra praktike.

Objektivat penalë që duhet të ketë shërbimi në komunitet kanë qenë objekt i shumë debateve. Juridiksionet e vënë fokusin te njëri nga tre objektivat - dënues, zhdëmtues dhe rehabilitues - ose e ndryshojnë këtë fokus me kalimin e kohës. Kohët e fundit është realizuar një studim krahasues i shërbimit në komunitet që parashikojnë juridiksionet evropiane, i cili konstaton se po rritet fokusi te aspekti ndëshkues i punës së papaguar (p.sh. priorizojnë punë krahu të vështirë që është “e dukshme”), si mënyrë për të fituar mbështetjen e publikut dhe gjyqësorit, ndërkohë që objektivi rehabilitues është kufizuar kryesisht te reduktimi i recidivizmit.

Nisur nga objektivat e ndryshme, ndikimi i shërbimit në komunitet vlerësohet në mënyra të ndryshme. Në nivel praktik, puna që kryejnë të dënuarit mund të vlerësohet nga ana sasiore qoftë financiarisht, qoftë edhe si orë pune. Kjo punë shpesh rezulton në përfitime konkrete, sepse, për shembull, përmirëson shërbimet lokale. Në nivel ndërpersonal, kemi një ndërveprim të përditshëm të personit që kryen punën e papaguar me personat përfitues të saj, por ende kemi relativisht pak informacion për natyrën dhe ndikimin - pozitiv apo negativ të këtij ndërveprimi.

Megjithatë, kemi disa prova për përfitimet “produktive/gjenerative” dhe “ri-integruese” te të dënuarit, sepse e ndjejnë se po i kthejnë diçka komunitetit. Për shembull, konstatohet se shkelësit e çmojnë mundësinë për të përftuar aftësi të reja, si edhe kryejnë punë që vlerësohet nga përfituesit; gjithashtu, të dënuarit që kanë pasur përvojë pozitive me shërbimin në komunitet kanë probabilitet më të ulët për të përsëritur veprën penale.

Shërbimi në komunitet mund të ketë ndikim ri-integrues, sepse iu krijon mundësinë shkelësve të vazhdojnë të punojnë vullnetarisht me organizatat komunitare (ndonjëherë edhe me pagesë), pasi përfundojnë punën e papaguar të urdhëruar nga gjykata.

Për sa i përket përsëritjes së veprës penale, edhe pse kërkohen më shumë të dhëna, tashmë ekzistojnë disa prova se shërbimi në komunitet është më i efektshëm sesa burgimi. Për

shembull, të dhënat e qeverisë scoceze tregojnë përqindje më të ulët të personat që iu është dhënë shërbim në komunitet, sesa të personat e dënuar me burgim, sidomos të të dënuarit me precedentë penalë të shumtë.

Një studim i shërbimit në komunitet në Zvicër konstatoi përqindje më të ulët ridënimi të të dënuarit që iu ishte dhënë shërbim në komunitet, sidomos mes atyre që e konsideronin këtë dënim të drejtë. Një tjetër studim në Holandë, që analizoi një periudhë 8-vjeçare, vërejti përqindje më të ulët ridënimi për krimet ndaj pronës dhe krimet e dhunshme tek shkelësit e dënuar me shërbim në komunitet.

## Pyetja 10

### Cilat janë përfitimet dhe kostot e vënies në provë?

nga Faye S. Taxman

George Mason University (SHBA)

Si një mjet dënimi me bazë komunitetin, shërbimi i provës ofron një gamë përfitimesh tre-palëshe; për të dënuarin, komuniteti në përgjithësi dhe sistemin e drejtësisë. Personi qëndron në komunitet duke shlyer në të njëjtën kohë “dënimin ndaj shoqërisë,” ndërkohë që vazhdon të gëzojë përgjegjësitë qytetare si p.sh. punësimin, detyrimet familjare dhe detyrimet si anëtar i komunitetit. I dënuari mund të bjerë në kontakt me shërbimet komunitare (shërbime për abuzimin me substancat, shëndetin mendor, shërbime punësimi, etj.), që e ndihmojnë individin të rimarrë rolin si qytetar.

Shërbimi i provës mbështetet në këto burime komunitare dhe mund të kontribuojë në krijimin e organizatave me bazë komunitare që plotësojnë nevojat e gjera të komunitetit si shërbimet e sjelljes pro-shëndetit, parandalimin e krijimit të bandave dhe rezistencën ndaj tyre, mbështetje për strehimin, si edhe rrjetet e mbështetjes sociale. Organizatat komunitare, qofshin shtetërore apo jofitimprurëse, janë aktorë të rëndësishëm si për shërbimin e provës, ashtu edhe për personat e vënë në provë, sepse iu mundësojnë këtyre të fundit të shlyhen me shoqërinë përmes punës në komunitet. Gjithashtu, vetë shërbimet mund të krijojnë shërbime mbështetëse të posaçme për personat e vënë në provë që ata të mos bien sërish në konflikt me drejtësinë.

Fleksibiliteti i vënies në provës (në disa juridiksione), qoftë si masë individuale, apo si platformë e ndërthurur me komponentë të tjerë që synojnë ndryshimin e sjelljes së të dënuarit dhe mbajtjen e tij larg krimit, është thelbësor. Personi mund të kontribuojë në komunitet duke paguar gjokat, tarifatat e vënies në provë (në disa juridiksione), dëmshpërblimit dhe zgjidhjeve të tjera financiare.

Sistemi i drejtësisë mund ta aplikojë vënien në provë për t'i mbajtur larg të dënuarit nga krimi, duke i fokusuar kushtet e provës rreth faktorëve që i mundësojnë shkelësit të shlyhet me shoqërinë, të adresojë faktorët që kontribuojnë në kryerjen e shkeljes, dhe që e lejojnë të përftojë aftësi të reja (p.sh. shkollim, punësim, prindërim, etj.), me qëllim që të jetë kontribuues në shoqëri.

Kostot e provës janë po aq të ndryshme sa edhe përfitimet. Kostoja kryesore janë punonjësit e shërbimit të provës, administrata e shërbimit të provës, si edhe kostot e zyrës. Personeli i shërbimit të provës ka më pak kosto se personeli i qelive të burgut, sepse nuk është e nevojshme të punojë 24 orë, apo të ruajë një perimetër sigurie. Por, mbingarkimi me punë i personelit të provës rezulton në një reduktim artificial të kostove të vërteta të shërbimit të provës.

Sa më e lartë ngarkesa e punës, aq më pak mundësi ka personeli i provës të aplikojë praktika



të efektshme, si të menaxhojë rrezikun, të krijojë 'aleanca mirëkuptuese' (me të dënuarin në provë), për të krijuar te ai besim, për t'i menaxhuar dhe për t'i referuar çështjet, si dhe për të dhënë shërbime të caktuara. Pra, punonjësit e shërbimit të provës mund të arrijnë shumë nga qëllimet e një dënimi nëse u jepet koha e mjaftueshme për të adresuar rrezikshmërinë kriminogjene dhe nevojat e personit në provë.

Kostot e tjera kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve për adresimin e abuzimit me substancat, shëndetin mendor, punësimin, nevojat arsimore dhe nevojat e tjera të paplotësuara të personit në provë. Kostoja e vënies në provë varet krejtësisht nga ngarkesa e punës dhe nga aftësia e punonjësve të shërbimit të provës për të bërë lidhjen/përshtatjen e shkelësit me shërbimet me bazë komunitare. Në disa juridiksione, këto kosto zbriten nga të ardhurat e përfituara prej penaliteteve financiare si gjokat, tarifatat e vënies në provë, tarifatat e testit të drogës, rikthimi dhe kostot e tjera të lidhura me gjykatat.

Komuniteti mund të përfitojë nga vënia në provë për sa kohë ky dënim nuk e mbingarkon sistemin. Megjithatë, vetë sistemi mund t'i cenojë përfitimet e vënies në provë, nëse burimet janë të sforcuara dhe nëse të dënuarve u vihen aq shumë kushte, saqë ua bëjnë edhe më të rëndë dënimin. Vënia në provë është elastike për sa u përket qëllimeve, operacioneve dhe përfitimeve. Vlerësimi i kostove dhe përfitimeve duhet të mbajë parasysh saktësisht si funksionon në praktikë vënia në provë në një kontest të caktuar, por edhe qëllimet që ajo synon të arrijë.